

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.115 /2018	Data: 29.09.2018	

Kuvendi Komunal në bazë të nenit 40 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë", nr.28/2008), nenit 33.1 pika 2) të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2018, shqyrtoi Draft-Buxhetin Komunal 2019-2021 dhe mori këtë:

V E N D I M BUXHETI KOMUNAL 2019-2021

1. Miratohet Buxheti Komunal 2019-2021.
2. Buxheti Komunal 2019-2021 i paraqitur në format tabelore janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi:
 - tabela 4.1 Ndarjet buxhetore 2019-2021,
 - tabela 4.2 Projektet kapitale 2019-2021 dhe
 - tabelat 4.3 - Të hyrave vetanake 2019-2021.
3. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e komunës dhe për zbatimin e tij është përgjegjës: Kryetari i Komunës.
4. Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Ministria e Financave, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje në arkivin e këtij Kuvendi.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna

Nr: 01-039-08 Data 04-10-2018
 Br: _____ Datum: _____

ISTOG-ISTOK



Kryesuesi i Kuvendit,
Qaush Balaj



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.116/2018	Data: 27.09.2018	

Kuvendi i Komunës duke u bazuar në nenin 58 shkronja (m) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) e ne lidhje me nenin 8. paragrafi 8.3 të i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010,të miratuar me dt.30.11.2010, duke pasur parasysh kontributin për Republikën e Kosovës në kuptimin e avancimit dhe njohjes së saj në mekanizmat dhe institucionet evropiane dhe ndërkombëtare në mbledhjen e mbajtur me 27/09/2018. mori këtë:

V E N D I M PËR SHPALLJEN QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË ISTOGUT

1. Z,Peter Beyer MdB, i lindur me dt.25.12.1970 në Ratingen të Gjermanisë, shtetas i Gjermanisë, Anëtar i Komitetit të Punëve të Jashtme, Anëtar i Komitetit për Qeshje të Bashkimit Evropian (zëvendës kryetar) Anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg si dhe Koordinator për bashkëpunim transatlantik në Qeverinë Federale pranë zyrës së Jashtme Federale, për merita të veçanta dhe kontributin e dhënë ndaj qeshjes së shtetit të Kosovës dhe popullit të sajë, Shpallet Qytetar Nderi i Komunës së Istogut.
2. Ceremonia e dorëzimit të aktit të Shpallje Qytetar Nderi do të bëhet në seancë solemne të Kuvendit Komunal me qytetarë nga Kryetari i Komunës z.Haki Rugova.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij kujdesen; Kryetari i Komunës.
4. Më kopje të këtij vendimi të njoftohen Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe një kopje arkivi i Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-izlazna
 Nr: 01-039-7 Data 04.10.2018
 Br: Datum
 ISTOG-ISTOK


 KRYESUESI I KUVENDIT,
 Z. Qaush Balaj

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. 117/2018	Data: 27.09.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 3 paragrafi 1.3 dhe pika 1.11, neni 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 si dhe neni 7 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nr. 04/L-144, dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, në mbledhjen e mbajtur më: 27.09.2018, shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë komunale në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik mori:



V E N D I M

PARAPRAK PËR DHENJËN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

1. Sipërfaqja prej 800 m² nga njësia kadastrale nr: 000652-8, në zonën kadastrale Suhogerrllë, e evidentuar si PSH e Kuvendit Komunal, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për zhvillim ekonomik, përmes ankandit publik.
 2. Afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite.
 3. Obligohet Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës në shfrytëzim, të zbatojë procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së cekur në Pikë I të këtij Vendimi, përmes ankandit publik, në pajtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nr.04/L-144 dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.
 4. Pas marrjes së Vendimit, mbi përzgjedhjen e kompanisë, nga Komisioni vlerësues, në pajtim me procedurat e Ligjit dhe Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës do të lidhë kontratë me kompaninë e përzgjedhur më të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e kompanisë.
 5. Obligohet Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi, që pas përzgjedhjes së kompanisë, nga Komisioni vlerësues, të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Pikën I të këtij Vendimi.
 6. Ky vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e Komunës, për realizimin e ti ngarkohet Drejtoria Kadastër dhe Gjeodezi.
- Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi,, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr. 01-039-8 Data 04-10-2018
 Br. Datum
 ISTOG-ISTOK


 Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Qaush Balaj





REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 OPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY	 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.118 /2018	Data: 27.09.2018

Uales-izazna
 Nr. 01-03
 Br. 04.10.2018

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40.2 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen e lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më:27,09,18, shqyrtoi Transferi i mjeteve buxhetore të komunës për vitit 2018 të parashtruar nga Kryetari dhe mori:

V E N D I M

TRANSFERI DHE RI ALOKIMI I MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS PËR VITIT 2018

Miratohet Transferi dhe Ri alokimi i mjeteve buxhetore të buxhetit komunal të vitit 2018 si në vijim:

a) Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale (fondi burimor 10)

1. Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia - (180) kodi funksional (0451) nën-programi Infrastruktura rrugore (18017) te behet ri-alokimi i mjeteve nga projekti:

me kod 46230 "Ndërtimi i kanalizimit në Padalishta – lagja Fetahaj - Beqiraj" , në vlera 40,000.00 €, nga në projektet:

"Ndërtimi i kanalizimit lagja Januzaj në fshatin Lubozhdë" kodi 46236 ,vlera prej 5,000.00 €.

"Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore " kodi 46245, shuma prej 22,500.00 €.

"Blerje dhe furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit" kodi 43724, shuma prej 12,500.00 €.

Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia - (180) kodi funksional (0451) nën-programi Infrastruktura rrugore (18017) te behet ri-alokimi i mjeteve projekti:

41902 Rregullimi i Varrezave Ne Fsh. Kashicë - të ndryshohet dhe të emërtohet

41901 Rregullimi i varrezave në fsh..Lubozhdë

Në kuadër të programit 47017 Bujqësi, te behet ri-alokimi i mjeteve nga projekti me kod:46281 "Hapja e rrugës malore Lugu i Butë –Kodra e Dules" shuma 5,000.00 €

Në projektin me kod 46280:

"Hapja e rrugës malore Shoshan stane te Verës" , shuma prej 5,000.00 €.

Në kuadër të programit 19585- Zyra Komunale për komunitete dhe kthim, te behet ri-alokimi i mjeteve Nga projekti me kod:46252 "Ura e lumit ne fshatin Tomoc" ne vlerë prej 7,000.00 €

Në projektin me kod 46250: "Ndërtimi i trotuarit në rrugën Sarajeva në Dobrushë" , shuma prej 7,000.00 €.

Në kuadër të programit Zhvillimi Ekonomik - (480) kodi funksional (0411) nën-programi Infrastruktura rrugore (48017) te behet ri-alokimi i mjeteve nga projekti: me kod 46291 "Ndërtimi i rrugëve në Vrellë" , në vlera 10,000.00 €.

në projektin:

"Ndërtimi i rrugës në Orroberdë" kod 46299 ,vlera prej 10,000.00 €.

nga projekti: me kod 46287 "Ndërtimi i rrugëve në Banjë" , në vlera 26,500.00 €,

- në projektin:

"Ndërtimi i rrugës në Prigodë" kod 46303 ,vlera prej 26,500.00 €.

nga projekti: me kod 46282 "Hartimi i projekteve për Infrastrukturë" , vlera 40,000.00 €,

në projektin:

"Ndërtimi i rrugës në Prigodë" kod 46303 ,vlera prej 8,500.00 €.

b) Transfer i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale (fondi burimor 10)

2. Në kuadër të programit Zhvillimi Ekonomik - (480) kod funksional (0411) nën-programi Infrastruktura rrugore (48017) të bëhet ri-alokimi i mjeteve

nga projekti: me kod 46282 "Hartimi i projekteve për Infrastrukturë" , vlera 40,000.00 €,

- në projektin:

" Projekti me participim të Komunitetit, ministrive të linjës, donatoreve të jashtëm" me kod 46385 vlera 31,500.00 €

3. Obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa që më planin e Rishikimit të buxhetit komunal të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për procedim të mëtejshëm në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

4. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në web faqen zyrtare të komunës, për zbatimin e tij është përgjegjës Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministria e Financave, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

KRYESUESI I KUVENDIT

z. Qaush Balaj

